

**Njoftim për përqendrim me të cilin „Telekom Srbija” shoqëri aksionare, Beograd,
Republika e Serbisë do të fitojë kontroll mbi INTERCOM COMPUTERS SHPK
Quprija, Republika e Serbisë
(lënda nr. 08-88/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 22.05.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin „Telekom Srbija” shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën „Takovska” nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë INTERCOM COMPUTERS SHPK Quprija, me seli të regjistruar në rrugën Z Maj Jovina 2, 35230 Quprija, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

„Telekom Srbija” shoqëri aksionare, Beograd, është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikime me kablo, ndërsa nga shërbimet që ofron, veçohen shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile, internetit dhe shërbimeve multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

„Telekom Srbija” shoqëri aksionare Beograd ka një person të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe ajo është:

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën „Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë: telekomunikime me tela, gjegjësisht për ofrimin e këtyre shërbimeve: rrjet publik radio-komunikues, qasje të gjerë në internet, shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike publike në rrjetin publik të komunikimeve mobile, ri-transmetim të shërbimeve të programeve televizive, satelit.

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup ka një person të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe ajo është: Shoqëria për telekomunikime LAJKAMOBIL SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rrugën „Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër.

Shoqëria për telekomunikime LAJKAMOBIL SHPKNJP Shkup operon në tregun për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile (shërbime prepaid) dhe nuk ofron përdoruesve të saj finalë shërbime mobile postpaid. Shoqëria për telekomunikime LAJKAMOBIL SHPKNJP Shkup është operator virtual i rrjetit mobil (OVRM) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime të thirrjeve, SMS-ve dhe internetit, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, përfshirë edhe shërbimet roaming.

Gjithashtu, person i lidhur i „Telekom Srbija” shoqëri aksionare Beograd në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup („TOTAL TV SHPK Shkup”), me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtari të telekomunikimeve satelitore.

INTERCOM COMPUTERS SHPK Quprija, është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për ofrimin e shërbimeve të qasjes së gjerë fikse në internet, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike në territorin e Republikës së Serbisë.

INTERCOM COMPUTERS SHPK Quprija nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllimet e vlerësimit të këtij përqendrimit, duhet të merren parasysh tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse me brez të gjerë në internet, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike, duke pasur parasysh veprimtarinë e INTERCOM COMPUTERS SHPK Quprija.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka konstatuar se ky përqendrim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

27.05.2025

Shkup